

Republika e Sërbisë
 KOMUNA E PRESHEVËS
 KUVENDI KOMUNAL
 Komisioni për hartimin e Programit vjetor
 të mbrojtjes, rregullimit dhe shfrytëzimit
 të tokës bujqësore të komunës së Preshevës
 I. Numër: 320 - 81 /2021
 Më 22.09.2021
 P r e s h e v ë

THIRRJE PUBLIKE

PËR DËSHMIN E SË DREJTËS NË PËRPARSI TË MARRJES ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE NË PRONSI SHTETRORE NË TERITORIN E KOMUNËS SË PRESHEVËS PËR VITIN 2022.

Në pajtim me Ligjin mbi tokën bujqësore ("Fl.zyrtare e RS", nr. 62/06, 65/08- Ligji tjetër, 41/09 , 112/2015 , 80/17,dhe 95/18 –dhe ligjet tjera) dhe Rregullores mbi kushtet dhe procedurën e dhënjes me qira dhe në shfrytëzim të tokës bujqësore në pronësi shtetërore ("Fl.zyrtare e RS", nr. 16/2017 , 111/17, 18/2019, 45/2019, 3/2020 dhe 25/2020), Komisioni për hartimin e Programit vjetor të mbrojtjes, rregullimit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore të komunës së Preshevës shpallë **Thirrje publike** për të gjithë personat fizikë dhe juridik, me të cilën i njoftonë:

- pronarët e sistemeve për ujitje, drenazhë, hurdhja peshku, objektin bujqësor, serave dhe të mbjellurave shumëvjeçare (pemishteve dhe vreshtave të cilët janë në frytshmëri), në tokën bujqësore në pronësi shtetërore dhe të cilët janë të regjistruar në regjistrin e ekonomive bujqësore dhe kanë status aktiv së paku tri vite, (në tekstin vijues: infrastruktura bujqësore) dhe
- pronarët e kafshëve shtëpijake, të cilët janë edhe pronarë, gjegjësishtë qiramarrës të objekteve për ruajtjen e kafshëve në teritorin e njësisë së vetqeverisjes lokale në të cilën realizohet e drejta në përparsi të qiramarrjes, të cilët janë të regjistruar në Regjistër të ekonomive bujqësore dhe janë në status aktivë së paku një vit (në tekstin vijues: Blektorija),

Ta dorzojnë dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar të drejtën e përparësisë në qiramarrje të tokës bujqësore në pronë shtetërore në teritorin e komunës së Preshevës për vitin 2022, deri më 31.Tetor 2021.

DOKUMENTACIONI PËR DËSHMINË E TË DREJTËS SË PËRPARËSISË SË QIRAMARRJES

I. Dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e të drejtës së përparësisë në qiramarrje në bazë të pronësisë në infrastrukturën bujqësore është:

1. Kërkesa për pranimin e të drejtës në përparësi të qiramarrjes në bazë të pronësisë së infrastrukturës bujqësore e nënshkruar nga ana e personit fizikë, gjegjësishtë personit përgjegjës tek personi juridik (*e dorzonë paraqitësi i kërkesës*);
2. Dëshmia e pronësinë ndaj infrastrukturës:
 - a). Ekstrakti nga evidenca publike e të së patundshmes për infrastrukturën bujqësore e cila është evidentuar në evidencën publike të patundshmërisë (e siguron njësia e vetadministrimit lokalë) dhe/ ose
 - b).Lista regjistruse dhe dokumentacioni i kontabilitetit i nënshkruar dhe i vërtetuar në pajtim me Ligjin mbi kontabilitetin për personat juridikë,për infrastrukturën bujqësore e cila nuk është e evidentuar në evidencën publike mbi patundshmërinë (*e dorzonë paraqitësi i kërkesës*) dhe/ ose
 - v). Pëlqimin/Lejimin e Ministrisë kompetente për punët e bujqësisë në investimet investionale për infrastrukturën bujqësore e cila është ngritur pas korrikut të vitit 2006,gjegjësishtë kontrata mbi shitëblerjen për personat fizikë (*paraqitësi i kërkesës*) me personin juridik i cili e ka ngritur infrastrukturën bujqësore në pajtim me ligjet në fuqi të asaj kohe(*e dorëzon paraqitësi i kërkesës*).
3. Procesverbalin e Inspektionit Republikan të bujqësisë (*e dorëzoë paraqitësi i kërkesës*);

4. Dëshmi që parqitsi i kërkesës është bartës ose anëtar i Ekonomis së regjistruar bujqësore me status aktiv së paku tri vite (*e siguron njësia e vetadministrimit lokal*) ;

II. Dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e të drejtës në përparsi të qiramarrjes në bazë të Blegtorisë është:

1. Kërkesa për njohjen e të drejtës në përparsi të qiramarrjes në bazë të Blegtorisë e nënshkruar nga ana e personit fizikë, gjeqsishtë personit përgjegjës tek personi Juridik (*e dorëzon paraqitsi i kërkesës*);
2. Dëshmi që parqitsi i kërkesës është bartës ose antar i Ekonomis së regjistruar bujqësore me status aktiv su paku një vit (*e siguron njësia e vetadministrimit lokal*) ;
3. Dëshmi që personi juridik ose fizik është pronarë i kafshëve shtëpijake dhe pronarë, gjeqsishtë qiramarrës i objektit për ruajtjen e atyre kafshëve me numrin e përcaktuar të kafshëve të përzgjedhura:
 - a). Vërtetimin mbi numrin e kafshëve të cilën e lëshonë Instituti për blektori në Beograd-Zemun (me përjashtim të kuajve të cilën e lëshonë Fakulteti i bujqësisë Beograd-Zemun), gjeqsisht për teritorin e KA të Vojvodinës fakulteti i bujqësisë në Novi Sad-Departamenti për Blegtori për kafshët në sistemin e amzimit (*e dorzonë paraqitsi i kërkesës*);
 - b). Procesverbalin e Inspektorit Republikan të veterinarisë - për kafshët që nuk janë në sistemin e amzimit (*e dorzonë paraqitsi i kërkesës*);

(**Vërejtje:** Inspektori Republikan i veterinarisë me proçesitverbal e konstaton numrin e kafshëve të përzgjedhura të cilët i llogarit në bazë të gjendjes së gjetur, **gjeqsisht dokumentin e personit mbi shitjen, dorzimin për therrje dhe mbi eksportimin e kafshës**).
4. Kontratat mbi marrjen me qira të tokës bujqësore të kontraktuara me personat tjerë për tokën e cila gjindet në teritorin e njësisë së vetadministrimit lokalë për të cilën paraqitet kërkesa, e të cilët janë të vërtetuar nga ana e organit kompetent (*e dorzonë paraqitsi i kërkesës*);
5. Deklarata e parqitsit të kërkesës me të cilën jep pëlqim që të bëhet kontrollimi i të dhënave tek organet kompetente të cilët janë të domosdoshme për realizimin e thirrjes publike;
6. Deklarata e parqitsit të kërkesës mbi saktësin e të dhënave, e nënshkruar nga ana e personit fizikë gjeqsishtë personit përgjegjës tek personi Juridik, e dhënë me përgjegjsi të plotë penale, kundërvajtje dhe materjale, e cila përmbanë:
 - Deklaratën se i ka dorzuar të gjitha dëshmitë të cilët mbështeten në qiramarrëjen e tokës bujqësore në teritorin e vetadministrimit lokal në të cilën është paraqitur kërkesa;
 - Listën e personave të ndërlidhur (emërtimi i personit juridik me numrin amë /emrin dhe mbiemrin e personit fizik, farefisnia dhe NUAQ).

(**Vrejtje:** tek personat fizik persona të ndërlidhur janë: gjyshi, nena, nëna, baba, fëmijët, bashkëshorti, fëmij i adaptuar, partner jashtë kurore nëse e kan vendbanimin në të njëjtën adresë; **Tek personat juridik si persona të ndërlidhur konsiderohen:** Personi juridik dhe/ ose personi fizik i cili ka së paku 25% pjesmarje në kapitalë (akcione, pjesmarje ose vota).
7. Vërtetimin nga evidenca publike e patundshmërisë me të cilën dëshmohet sipërfaqja e tërsishme e tokës bujqësore të cilën paraqitsi i kërkesës e posedon në posedim të tij në teritorin e vetadministrimit lokal në të cilën paraqitet kërkesa (*e siguron njësia e vetadministrimit lokal*) ;
8. Vërtetimin nga evidenca publike e patundshmërisë me të cilën dëshmohet sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore e cila është në pronsi të personave të ndërlidhur me paraqitsin e kërkesës. (*e siguron njësia e vetadministrimit lokal pas shiqimit në listën e atyre personave nga deklarata nga pika 6. Të cilën e dorëzon paraqitsi i kërkesës*).

Të gjitha kufizimet nga neni 64a. alineja 17. E Ligjit mbi tokën bujqësore (kontrata me personat tjerë, pronsija e tokës bujqësore, pronsia e tokës bujqësore e personave të ndërlidhur, marja me qira e tokës bujqësore në pronsi shtetore) mbështeten në teritorin e njësisë së vetadministrimit lokalë ku ndodhet objekti, gjeqsishtë kafshët. Vërejtje: të gjithë personat që janë të interesuar për realizimin e të drejtës në përparsi të marrjes me qira në bazë të infrastrukturës bujqësore janë të obliguar që me kohë, e më së voni deri më **10.Tetor 2021**, paraqesin kërkesë për daljen e inspektionit republikan të bujqësisë, gjeqsisht për realizimin e të drejtave në përparsi të kërkesës në bazë të blegtorisë **kërkesa për daljen e inspektionit republikan të veterinarisë më së voni deri më 10.Tetor 2021**.

Procesverbali i inspektionit republikan të bujqësisë është pjesë përbërse e dokumentacionit e cila dorëzohet deri më 31.Tetor 2021 dhe gjithsesi përmban saktësisht të gjitha parcelat e shënuara kadastrale ose pjesët e parcelave, në të cilat është përcaktuar funksionalizimi i sistemit për ujitje, drenazhë, peshqit, objektet bujqësore, serat si dhe pemët dhe pemët frytëdhënëse dhe vreshtat);

Dokumentacioni nga pjesa I. e pikës 2a. Dhe 4, gjegjësisht nga pjesa II. Pika 2,7 dhe 8, njësia e vetadministrimit lokal e siguron më së voni deri më 30. Nëntor të vitit 2021.

Njoftojmë se tek personat të cilët i plotsojnë kushtet për realizimin e të drejtës në përparsi të qiramarrjes në bazë të blektorisë, në pajtim me këtë thirrje publike, përcaktimi i sipërfaqës së tokës bujqësore në pronësi shtetërore në Programin vjetorë të mborjtjes, rregullimit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore bëhet në mënyrë që sipërfaqja e cila ju ka caktuar në bazë të numrit të krerëve të prazjedhur, zvoglohet për sipërfaqën e tokës bujqësore, në pajtim me nenin 64a. Alineja 17. E ligjit mbi tokën bujqësore ("Fleta zyrtare e RS", numër 62/06,65/08- ligji tjetër, 41/09 dhe 112/2015 dhe 80/2017).

I tër dokumentacioni i cili dorëzohet në pajtim me këtë thirrje publike duhet **të jet e adresuar në emër të njejt person fizik apo juridik**, i cili mund të jet bartës ose antarë i Ekonomisë së regjistruar bujqësore dhe duhet të jetë e vërtetuar dhe e nënshkruar nga ana e organit kompetent i cili e lëshonë dokumentin.

Nëse personi juridik ose fizikë është pronarë i më shumë llojeve të kafshëve, për çdo llojë kafshe duhet ta dorëzoj vërtetimin e veçantë, gjegjësishtë procesverbalin nga pjesa II. Pika 3.

Për periudhën e qiramarrjes e cila është më gjatë se një vit, përveç pagesës së qirasë për vitin e parë të qiramarrjes, për arsye të nënshkrimit të kontratës mbi qiramarrjen e nevojshme është që të dorëzohet edhe mjeti i sigurimit të pagesës, e cila mundet të jetë: Garancioni i bankës afariste në lartsi të vlerës vjetore të qiramarrjes së tokës bujqësore ose kontrata mbi lidhjen ndërmjet Ministrisë si kreditore dhe personit juridik si garantues ose dëshminë mbi pagesën e depozitit në lartsi të qiramarrjes për një vit si mjet i sigurimit të pagesës së qiras e cila në rastë të pagesës së rregulltë do të llogaritet si pagesë e qirasë për vitin e fundit të pagesës së qirasë.

Nëse parcelat kadastrale të cilët ju kanë ndarë personave në bazë të drejtës së përparsisë në qiramarrje vjen deri te ndrimi i sipërfaqës çvarido baze ligjore.procedura e më tutjeshme e dhënjes së tokës bujqësore me qira sipas së drejtës në përparsi të qiramarrjes do të realizohet vetëmse në sipërfaqën e caktuar ashtu.

Formulari i kërkesës mundet të mirret çdo dit pune prej orës 08⁰⁰deri në ora 14⁰⁰, në zyrën e drejtoratit për ekonomi, zhvillim ekonomik-lokalë dhe administratë tatimore lokale, Administratës komunale Preshevë , rruga M.Tito nr. 36, kati i parë, zyra nr.36 Preshevë.

Afati për dorëzimin e kërkesave dhe të dokumentacionit të nevojshëm nga kjo thirrje publike është 31.tetorë 2022. Kërkesa e arritur pas skadimit të datës së caktuar në këtë thirrje publike do të konsiderohen si e dorëzuar jo me kohë dhe komisioni do ti ja kthejë dorëzimit të kërkesës, të pa hapur.

Kërkesa me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet drejtë për së drejti në shkresore ose nëpërmjet postës, në zarfë të mbyllur të adresuar në anën e përparme: "Kërkesë për realizimin e të drejtës në përparsi të qiramarrjes në bazë të pronsisë në infrastrukturë bujqësore për vitin 2022", ose "Kërkesa për realizimin e të drejtës në përparsi të qiramarrjes në bazë të blegtorisë për vitin 2022", për *Komisionin për haritim e Programit vjetorë të mbrojtjes, rregullimit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore në teritorin e komunës së Preshevës*, në adresën: Drejtorati për ekonomi, zhvillim ekonomik-lokalë dhe administratë tatimore lokale të Administratës komunale Preshevë, rruga M.Tito nr. 36 kati i parë, zyra numër 36 Preshevë. Në anën e mbrapme të zarfit cekët emërtimi/emri dhe mbiemri dhe adresa e paraqitit të kërkesës.

Personi kontaktus për çdo informacion në lidhje me këtë thirrje publike është: Nehat Murati tel.mob. 066/5157585 ose 063/7639991, email: nehataga@live.com ose personalisht në hapsirat e Drejtoriatit për ekonomi, zhvillim lokal ekonomik dhe administratë lokale tatimore, të Administratës komunale Preshevë, rruga M. Tito nr.36, kati i parë, zyra nr. 36 Preshevë.

Kjo thirrje publike të shpallet në veb sajtin e komunës së Preshevës www.presevo.rs , në panelin e shpalljeve të Administratës komunale të komunës Preshevë dhe në panelet e shpalljeve të zyreve të vendit.

Kryetarja e komisionit

Nehat Murati